

## SYLLABUS I LËNDËS

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Edukimit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Praktika pedagogjike II</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi i lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>II-të, semsetri i IV-të</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E premtë / Grupi 1: 9:00 -11:15/ Salla e praktikës pedagogjike Grupi 2: 11:15-13:30/ Salla e praktikës pedagogjike</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Ass. Dr. Sc. Jehona Ferizi Miftari</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>Fakulteti i Edukimit, K i IV-të, zyra nr. 16 <a href="mailto:jehona.ferizi-miftari@uni-pr.edu">jehona.ferizi-miftari@uni-pr.edu</a></b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p><i>Praktika Pedagogjike II ofron mundësi të zhvillimit të shkathtësive për zbatim të suksesshëm të parimeve e strategjive të mësimdhënies, meqë rast studentët do të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës.</i></p> <p><i>Në Praktikën pedagogjike II, studentët do të zhvillojnë aftësitë për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies, si dhe do të shohin funksionimin e shkollës si organizatë.</i></p> <p><i>Lënda Praktika pedagogjike II, organizohet në 15 javë ligjërata, në kuadër të tyre nga 3 ditë për 7 javë praktikë e drejtpërdrejtë në shkollë, duke mundësuar kështu lidhjen e teorisë së mësuar me praktikën. Gjatë 7 javëve në praktikën pedagogjike II, studentët do të dokumentojnë në portofol përvojën e tyre, të sjellë nëpërmjet detyrave/ projekteve/ në procesin e vëzhgimit dhe mësimdhënies në shkollën përkatëse, sipas udhëzimeve dhe detyrave të dhëna nga profesori i lëndës.</i></p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p><i>Qëllimi parësor i Praktikës pedagogjike II, është që studentëve t'u ofrohen mundësitë për t'i zhvilluar shkathtësitë për planifikim të aktiviteteve të mësimdhënies në klasë, përfshirë edhe veprimtaritë për vlerësimin e të nxënësve.</i></p>

**Rezultatet e pritura të nxënies:**

**NJOHURITË**

- Identifikojnë parimet e mësimdhënies efektive;
- Analizojnë strukturën organizative të orës mësimore;
- Reflektojnë për aspekte të planifikimit të një ore mësimore për klasat 1 deri 5, bazuar në Kornizën Kurrikulare të Kosovës dhe Kurrikulën bërthamë;
- Demonstrjnë shkathtësi të zbatimit të strategjive të mësimdhënies bazuar në Kornizën e Kurrikulës të Kosovës;
- Përfshihen në planifikim të aktiviteteve të integruara ndërlëndore;
- Planifikojnë aktivitete që promovojnë qasjet bashkëkohore të mësimdhënies dhe vlerësimit të nxënësve;
- Zhvillojnë materiale për mësimdhënie dhe të nxënë që janë në përputhje me rezultatet e të nxënit dhe të përshtatshme për situata të ndryshme;
- Përzgjedhin dhe shfrytëzojnë teknologji relevante për të përmirësuar qasjen ndaj të nxënit, mësimdhënies dhe vlerësimit;
- Përzgjedhin instrumente dhe kritere relevante të vlerësimit formativ;
- Planifikojnë aktivitete të menaxhimit të klasës për të krijuar një mjedis pozitiv për të mësuar;
- Demonstrjnë strategji të ndryshme për menaxhimin e aktiviteteve në klasë;
- Analizojnë zbatimin e stileve të ndryshme të të mësuarit në punën e mësimdhënies dhe arritjet e nxënësve duke respektuar parimin e diversitetit.

**SHKATHTËSITË**

- Krijojnë mundësi se si metodat dhe qasjet e reja të mësimdhënies mund të inkorporohen në klasa;
- Zbatojnë në mënyrë të pavarur njohuritë, shkathtësitë e shprehite e fituara në kuadër të lëndës;
- Hulumtojnë shumëllojshmëri materialesh dhe burimesh mësimore.

**VLERAT**

- Respektojnë aftësitë dhe përpjekjet e secilit fëmijë për të krijuar mënyrën e vet të të nxënit;
- Ruajnë me kujdes materialet e regjistruara të punës së fëmijëve;
- Ruajnë konfidencialitetin e të dhënave rreth nxënësve (fëmijëve) dhe shkollës ku kryejnë mësimin praktik;
- Zbatojnë rregullat e shkollës për shfrytëzim të sigurtë të materialeve dhe mjeteve për punë me nxënës, duke përfshirë edhe TIK-un;
- Respektojnë idetë e të tjerëve;
- Kryejnë të gjitha obligimet me profesionalizëm, përkushtim, integritet dhe kompetencë.

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike	/	/	/
Punë praktike	5	7	35
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Projekte	1	1	1
Detyra të shtëpisë	4	7	28
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	1	3
<b>Totali</b>			157
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, punë në grupe, punë në cifte, punë individuale, metoda ndërvepruese të mësimdhënies, shkrim reflektiv, punë praktike, punë me projekte.		

**Metodat e vlerësimit:**

Në vlerësimin përfundimtar kanë të drejtë të paraqiten vetëm studentët që kanë marrë pjesë në ligjërata dhe të cilët kanë përfunduar me sukses mësimin praktik në shkollë.

Vlerësimi i studentëve ngërthen në vete dy pjesë: provimi (50%) dhe detyrat në mësimin praktik në shkollë (50%).

Studentët angazhimin e tyre do ta paraqesin përmes *E - Portfolit*. Portofoli i të nxënit është koleksionimi i kontributeve dhe paraqet përpjekjet, progresin dhe arritjet e studentit në kuadër të Praktikës pedagogjike II.

*Gjatë 7 javëve në praktikën pedagogjike II, studentët do të dokumentojnë në E-portofol përvojën e tyre, të sjellë nëpërmjet këtyre detyrave/ projekteve:*

**Detyra 1: Shkrimi reflektiv / Punë individuale (10 pikë)**

Studentët do të reflektojnë dhe do të ndajnë përvojat edhe me kolegët për çështje me rëndësi bazuar në tematikat e syllabusit. Detyra reflektive do të fokusohet në aspektet të cilat i përcakton profesori i lëndës. Reflektimi do të mundësoj që të analizohen përvojat dhe të merret një perspektivë e punës së përditshme që zhvillohet në klasë, konteksti në të cilin operojnë mësimdhënësit, kultura organizative. Shkrimi reflektiv nuk duhet të ketë më shumë se 500 fjalë.

**Detyra 2: Aspekte të planifikimit të mësimin në linjë me Kurrikulën e Kosovës të bazuar në të nxënë aktiv; Punë në grup/ (15 pikë)**

Studentët do të planifikojnë dhe do të realizojnë një aktivitet në linjë me Kurrikulën e Kosovës të bazuar në të nxënë aktiv (qasjet bashkëkohore të mësimdhënies) me qëllim të përfshirjes produktive të të gjithë nxënësve në klasë (punë individuale)/Planifikimi dhe realizimi i aktivitetit duke integruar edhe vlerësimin për nxënie, në njërin nga qasjet bashkëkohore të mësimdhënies (Të nxënit e bazuar në projekte; Të nxënit e bazuar në probleme; Të nxënit përmes lojës konstruktive; Qasja e bazuar në tema; Të nxënit ndërmarrës-Mësimi autentik).

**Detyra 3: Menaxhimi i klasës; Punë individuale (10 pikë)**

Studentët do të realizojnë një aktivitet që u ka shërbyer për të shpërblyer dhe inkurajuar sjelljen e dëshirueshme në klasë ose për të menaxhuar sjelljen jo të mire.

**Detyra 4: Planifikimi bazuar në dokumentet dhe kërkesat kurrikulare; Punë në grup/ (15 pikë)**

Studentët do të:

- planifikojnë korrelacionin në mes dy e më shumë fushave ose në mes lëndëve në funksion të arritjes së një competence;

Nota	6	7	8	9	10
Përqindjet	55-60%	61-70%	71-80%	81-90%	91-100%

- ✚ identifikojnë një fushë mësimore në një nivel të caktuar të klasës;
- ✚ identifikojnë së paku një kompetencë që do të nxitet nga një mësim/aktivitet që e do ta realizojnë;
- ✚ shkruajnë së paku dy rezultate të të nxënit që ndërlidhen me fushën mësimore dhe kompetencën e identifikuar më lart;
- ✚ zbërthejnë këto rezultate në kritere suksesi



<p><b>Literatura bazë:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjërata e përgatitur nga mësimdhënësi</li> <li>• Basic Education Program&amp; MASHT. (2013). Zhvillimi i shkathtësive të shekullit 21 në klasat me nxënësin në qendër</li> <li>• Dunn, D. (2017). How to be an Outstanding Primary School Teacher 2nd edition. Bloomsbury Publishing.</li> <li>• Eggen, P., &amp; Kauchak, D. (2011). Strategies and models for teachers: Teaching content and thinking skills. Pearson Higher Ed.</li> <li>• Fakulteti i Edukimit. (2004). Doracaku për mësimin praktik(Programi fillor).</li> <li>• Grup autorësh. (2013). Vlerësimi në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësit. Prishtinë.</li> <li>• Hoxha, Rr. (2023). Të nxënit përmes përvojës/ Metodologji praktike e mësimdhënies.</li> <li>• MASHT &amp; GIZ. (2013). Mësimdhënia dhe të mësuarit.</li> <li>• MASHT. (2016). Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar) Prishtinë.</li> <li>• Potter, M. (2015). 100 Ideas for Primary Teachers: Behaviour Management. Bloomsbury Publishing.</li> <li>• UNESCO. (2006). Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse: Një udhëzues për mësues dhe trajnerë; UNESCO dhe Save the Children (2007); Programi për Shqipërinë (varianti shqip).</li> <li>• <a href="https://resourcecentre.savethechildren.net/sites/default/files/documents/positive_discipline_in_the_inclusive_learning_friendly_classroom_albanian.pdf">https://resourcecentre.savethechildren.net/sites/default/files/documents/positive_discipline_in_the_inclusive_learning_friendly_classroom_albanian.pdf</a></li> </ul>
<p><b>Literatura shtesë<sup>1</sup>:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>☐ Arends. Richard et al. (1998). Exploring teaching. Mc Graw Hill</li> <li>☐ Arends. Richard. (1998). Learning to Teach. Mc Graë Hill</li> <li>☐ Burke, Walsh, K. (2013). Krijimi i mjedisit për të nxënit për shekullin XXI/ (autorë: Suzana Kiranxhiska, Tatjana Llazarevski, Gjorgjieva), - Shkup: Projekti për arsimin fillor</li> <li>☐ Deva-Zuna, A dhe bashkautorët. (2009). Partneriteti shkollë-familje –komunitet. Prishtinë: Libri Shkollor.</li> <li>☐ Jalongo, Renck M. Isenberg, J. (1995). Teachers’ stories.</li> <li>☐ Miller, Bonnie. (2004). Komunikimi me fëmijë. Doracak për prindër dhe arsimtarë. Ferizaj: QPEA.</li> <li>☐ Musai, B. (2014, botimi i 2-të). Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: CDE.</li> <li>☐ Oakes, Jeannie. Lipton, Martin. (2008). Teaching to change the eorld. Thrun, S., &amp; Pratt, L. (Eds.). (2012). Learning to learn. Springer Science &amp; Business Media.</li> <li>☐ Dawson, C. (2018). 100 Activities for Teaching Study Skills. SAGE Publications Limited.</li> </ul>

Kumar, R. (2017). Metodologjia e hulumtimit (një udhëzues hap pas hapi për fillestarë).

☒ Sofokli Garo. (2011). Metodologjia dhe praktika e mësimdhënies. Tiranë.

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Njoftim me programin, obligimet, procesin e vlerësimit, literaturën metodologjinë e mësimdhënies dhe propozime eventuale
Java e dytë:	Kompetencat profesionale të mësimdhënësit/ Çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet të bëj një mësimdhënës i mirë?
Java e tretë	Komunikimi dhe bashkëpunimi me akterët kryesorë të shkollës (me drejtorin e shkollës, aktivin profesional etj.) /Rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës
Java e katërt:	Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse - Dinamikat e klasës dhe menaxhimi i tyre
Java e pestë:	Strategjitë e menaxhimit në klasën gjithëpërfshirëse
Java e gjashtë:	Qasjet bashkëkohore të mësimdhënies: <ul style="list-style-type: none"><li>• Të nxënit e bazuar në projekte;</li><li>• Të nxënit përmes përvojës;</li><li>• Qasja e bazuar në të nxënit e integruar</li></ul>
Java e shtatë:	Qasjet bashkëkohore të mësimdhënies: <ul style="list-style-type: none"><li>• Të nxënit ndërmarrës - Mësimi autentik;</li><li>• Të nxënit përmes lojës konstruktive;</li><li>• Loja si mjet ndihmues në klasë</li></ul>
Java e tetë:	Planifikimi i punës mësimore dhe risitë kurrikulare
Java e nëntë:	Aspekte të planifikimit të mësimi në linjë me Kurrikulën e Kosovës të bazuar në të nxënë aktiv ( <i>qasjet bashkëkohore të mësimdhënies: të nxënit e bazuar në projekte; të nxënit përmes përvojës; qasja e bazuar në të nxënit e integruar</i> )
Java e dhjetë:	Aspekte të planifikimit të mësimi në linjë me Kurrikulën e Kosovës të bazuar në të nxënë aktiv ( <i>qasjet bashkëkohore të mësimdhënies: të nxënit ndërmarrës - mësimi autentik; të nxënit përmes lojës konstruktive; loja si mjet ndihmues në klasë</i> )

<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Planifikimi i orës së mësimi/ Elementet e planifikimit të mirë
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Vetëvlerësimi i studentit mësimdhënës lidhur me përvojat në klasë dhe zhvillimin e shkathtësive dhe njohurive profesionale
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Veprimtari praktike - vizualizimi i përvojës në punën praktike në shkollë
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Veprimtari praktike - vizualizimi i përvojës në punën praktike në shkollë
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Analizë e programit, në funksion të përmirësimit të praktikës profesionale, sygjerime për provim

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

- Asnjëri nuk ka të drejtë t'i ndërhyjë tjetrit kur ai e ka fjalën;
- Lejohet "zhurma" e punës kur studentët punojnë në grupe;
- Nuk lejohet prishja e qetësisë kur ligjërohet nga mësimdhënësi apo prezentohet puna e studentëve;
- Nuk lejohen telefonat celularë gjatë orëve mësimore dhe provimeve;
- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo dalja pa ndonjë arsye të qëndrueshme
- Në vlerësimin përfundimtar kanë të drejtë të paraqiten vetëm studentët që kanë marrë pjesë në ligjërata dhe të cilët kanë përfunduar me sukses mësimin praktik në shkollë;
- Dënohet cdo formë e kopjimit apo falsifikimit ...

#### **Përgjegjësitë e vijuesve të kursit**

- Të sigurojnë literaturën e rekomanduar për lëndën.
- Të përgatiten rregullisht për pjesëmarrje aktive në ligjërata.
- Të respektojnë idetë e të tjerëve.
- Të përmbushin detyrimet e kursit në afatet e caktuara.

#### **Përgjegjësitë e mësimdhënësit**

- Të prezantojë rregullisht në ligjërata ose në raste të jashtëzakonshme kur mungon, të informojë paraprakisht vijuesit për mungesën dhe kohën e kompensimit të orëve.
- Të udhëheqë dhe moderojë me efikasitet debatet, prezentimet dhe diskutimet për përmbajtje të temave të kursit.
- Të monitorojë dhe vlerësojë angazhimin dhe rezultatet e secilit vijues të kursit.
- Të mbajë portfolion e angazhimit të vijuesve.
- Të përgatisë instrumente të vlerësimit përfundimtar.